



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 44 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/19, dhe nenit 25.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010,

Në kërkesë të Kryetarit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-060/01-0045996/21 të datës 08 korrik 2021,

THËRRAS

Mbledhjen e LII-të (pesëdhjetë e dytë, mandati VI) e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **13 korrik 2021, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e Komunës së Podujevës, në orën 10;00, me këtë:**

Rend dite

- 1. Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2020 – 2028**
 - Propozim për vënie në shqyrtim publik
- 2. Zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB, (për shkak të ndërrimit të Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë)**

Mbledhja mbahet duke respektuar masat sipas vendimeve dhe akteve tjera të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe rekomandimeve të IKSHPK lidhur me situatën nga Pandemia Covid-19

Nr.prot.01-060/01-0055228/21
Podujevë,
08 korrik 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Për: Kuvendin e Komunës
z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit

Çështja: Kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit

Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që në bazë të nenit 44 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, me pikat e rendit të ditës:

- **Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2020 – 2028**
-Propozim për vënie në shqyrtim publik
- **Zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB,**
(për shkak të ndërrimit të Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë)

Kjo kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme bëhet për shkak të nevojave dhe rëndësisë së Hartës Zonale të Komunës, si dokument i veçantë i planifikimit hapësinor me ndikim, ndër të tjera, në zhvillimin ekonomik të Komunës. Çështje e cila rezulton si inicim nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit nga konsultimet e zhvilluara me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Vlen të potencohet se sipas të dhënave, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 30 tetor 2020, kjo çështje ka qenë në kuadër të rendit të ditës, mirëpo e njëjta unanimisht është shtyrë për shqyrtim në një mbledhje të radhës.

Sa i përket propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB, kjo bëhet duke iu referuar Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Andaj duke i'u referuar çështjeve të cekura, kërkohet të mbahet mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës si organ kompetent për shqyrtimin e temave në fjalë të propozuara.

Konsideroj si datë të përshtatshme për mbajtjen e mbledhjes të jetë 13 korrik 2021

Bashkëngjitur: dokumentacioni i projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020 - 2028

Nr.prot.01-060/01-0054996/21
Podujevë, 08 korrik 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buñiqi